

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

RAPORT I VLERËSIMIT

TË INSTITUCIONIT NGA STUDENTËT

VITI AKADEMIK 2024–2025

Institucioni	: Universiteti Metropolitan Tirana
Njësia përgjegjëse	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)
Periudha kohore	: 02 - 13 qershor 2025
Metoda e plotësimit	: Online – Edu4School
Numri i pjesëmarrësve	: 891 studentë
Përgatiti	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
Data e publikimit	: 23 qershor, 2025

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	4
Përbërja e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) për vitin akademik 2024-2025.....	5
Përbërja gjinore e studentëve.....	6
Përfaqësimi sipas programeve të studimit.....	6
I. SHËRBIMET INFORMATIVE DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT TË REGJISTRIMIT.....	9
Kënaqësia me përvojën e regjistrimit në programin e studimit.....	9
Regjistrimi i lëndëve semestrale.....	9
Efikasiteti i shërbimit për lëshimin e dokumenteve studentore.....	10
Mjaftueshmëria e informacionit në faqen e internetit të institucionit....	10
Përfundime mbi vlerësimin e shërbimeve administrative dhe informuese për studentët.....	11
II. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE MJEDISËT FIZIKE.....	12
Higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta të institucionit.....	12
Hapësira dhe ambienti në klasa dhe laboratorë.....	12
Përshtatshmëria e infrastrukturës teknologjike për nevojat e studentëve..	13
Kënaqësia me burimet dhe shërbimet e bibliotekës.....	13
Përfundime mbi infrastrukturën fizike dhe teknologjike në UMT.....	14
III. CILËSIA AKADEMIKE DHE MËSIMDHËNIA.....	15
Përputhshmëria e programit me interesat akademike.....	15
Raporti mes numrit të pedagogëve dhe studentëve.....	15
Mbështetja shtesë nga pedagogët jashtë orarit të mësimi.....	16
Mbështetja e këshillimit akademik.....	16
Efikasiteti i komunikimit me administratën dhe pedagogët.....	17
Organizimi i aktiviteteve jashtë kurrikulare për zhvillim profesional....	18
Mundësitë për praktika profesionale dhe përvojë pune.....	18
Përfundime mbi cilësinë akademike dhe mbështetjen në UMT.....	19
IV. PËRGATITJA PROFESIONALE DHE AVANTAZHET KONKURRUESE.....	20
Kënaqësia me zgjedhjen e UMT-së si institucion studimi.....	20
Aftësitë në gjuhë të huaja si avantazh profesional.....	21
Tarifat financiare të programit.....	22
Përmbledhje e kënaqësisë së studentëve mbi përgatitjen profesionale dhe kushtet në UMT.....	22
V. JETA SOCIALE DHE MJEDISI STUDENTOR.....	24
Aktivitetet sociale dhe kulturore në UMT.....	24
Kënaqësia nga shërbimet mjekësore.....	26
Jeta sociale dhe shërbimet mbështetëse në UMT.....	26
VI. PJESËMARRJA STUDENTORE DHE PËRFAQËSIMI.....	28

Përfaqësimi i studentëve në organet kolegjiale	28
Nxitja dhe hapja ndaj kërkesave të përfaqësuesve studentorë	28
VII. NDJENJA E PÛRKATËSISË DHE IMPLIKIMET PÛR TË ARDHMEN.....	30
Krenaria dhe besimi në diplomën e UMT-së	30
Krenaria për studimet në UMT	30
Perceptimi për mundësinë e përfundimit të studimeve në të gjitha nivelet në UMT	31
Sugjerimi i UMT si një nga zgjedhjet më të mira	31
Sugjeroj UMT për edukim cilësor dhe zhvillim	32
Përfundime mbi ndjenjën e përkatësisë dhe besimit në UMT	33
Vlerësimi i komenteve dhe sugjerimeve të studentëve.....	34

Hyrje

Vlerësimi i institucionit nga studentët përbën një komponent thelbësor në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të Universitetit Metropolitar Tirana (UMT). Si aktorët kryesorë të përvojës akademike, studentët ofrojnë perspektiva të rëndësishme dhe të pakrahasueshme mbi funksionimin dhe cilësinë e shërbimeve që u ofrohen. UMT e ka vendosur studentin në qendër të filozofisë së vet institucionale, duke e konsideruar pjesëmarrjen e tij aktive dhe feedback-un si element kyç për përsosjen e vazhdueshme të programeve, infrastrukturës, shërbimeve dhe ambientit akademik.

Ky raport synon të ofrojë një panoramë të detajuar dhe të balancuar mbi perceptimet, kënaqësitë dhe nevojat e studentëve, duke nxjerrë në pah aspekte pozitive dhe mundësi për zhvillim. Përkushtimi i UMT-së për një dialog të hapur dhe transparent me komunitetin studentor pasqyrohet në mënyrën sistematike dhe të kujdesshme të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, me qëllim të ngritjes së standardeve akademike dhe përmirësimit të vazhdueshëm institucional.

Përfshirja e studentëve si partnerë aktivë në këtë proces është garancia më e mirë për avancimin e UMT-së si një institucion modern, inovativ dhe me fokus të qartë në zhvillimin profesional dhe personal të secilit student.

Metodologjia

Ky vlerësim i institucionit është realizuar përmes një pyetësori të strukturuar, i cili është organizuar në mënyrë tematike mbi shtatë fusha kryesore:

- Shërbimet informative dhe administrimi i procesit të regjistrimit
- Infrastruktura teknologjike dhe mjediset fizike
- Cilësia akademike dhe mësimdhënia
- Përgatitja profesionale dhe avantazhet konkurruese
- Jeta sociale dhe mjedisi studentor
- Pjesëmarrja studentore dhe përfaqësimi
- Ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen.

Pyetësori u administrua në mënyrë elektronike përmes platformës Edu4School gjatë dy javëve të para të muajit qershor 2025, konkretisht nga 2 deri më 13 qershor. Procesi i mbledhjes së të dhënave u zhvillua në mënyrë anonime, duke siguruar konfidencialitet dhe lirshmëri në përgjigje

për të gjithë studentët pjesëmarrës.

Në këtë anketë morën pjesë gjithsej 891 studentë nga të gjitha programet e studimit të nivelit bachelor dhe master, duke garantuar një përfaqësim të gjerë dhe proporcional sipas përbërjes së komunitetit studentor në UMT. Ky numër i lartë pjesëmarrjeje rrit besueshmërinë dhe vlefshmërinë e të dhënave, duke mundësuar nxjerrjen e konkluzioneve objektive dhe të dobishme për institucionin.

Vlerësimi për secilin pohim është realizuar në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson vlerësimin minimal (aspak dakord) dhe 5 vlerësimin maksimal (plotësisht dakord). Në analizë, vlerësimet 4 dhe 5 janë konsideruar si pozitive, ndërsa 1 dhe 2 si shprehje të pakënaqësisë; vlerësimi 3 trajtohet si qëndrim neutral.

Metodologjia e ndjekur garanton një qasje sistematike dhe të strukturuar, që lejon identifikimin e pikave të forta dhe fushave për përmirësim. Për më tepër, përdorimi i platformës digjitale siguron lehtësi aksesimi dhe pjesëmarrjeje, duke krijuar kushte për një përfshirje sa më të gjerë dhe një përvojë të qetë përgjigjeje për studentët. Ky proces vlerësimi përbën një bazë solide për strategjitë e zhvillimit institucional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit dhe shërbimeve në Universitetin Metropolitar Tirana.

Përbërja e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë për vitin akademik 2024-2025

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues nga administrata, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor. Kryetari dhe anëtarët e njësisë janë miratuar nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.


Nr	Emri Mbiemri	Funksioni	Përfaqësimi
1	Dr.Nikolla Nika	Kryetar	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
2	Prof.Asoc.dr.Aranit Shkurti	Anëtar	Fakulteti i Ekonomisë
3	MSc. Virtyt Lesha	Anëtar	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
4	Prof.Asoc.Dr. Vita Koja	Anëtar	Administrata
5	Prof.Asoc.Dr. Ramadan Çipuri	Anëtar	Ekspert i jashtëm
6	Mateo Hysa	Anëtar	Përfaqësues i studentëve

Përbërja gjinore e studentëve

Nga gjithsej 891 studentë që morën pjesë në anketë, 59.9% janë meshkuj, ndërsa 40.1% janë femra. Ky raport tregon një përfaqësim më të lartë të meshkujve në grupin e anketuar, duke reflektuar strukturën aktuale gjinore të studentëve në institucion.

Gjinia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	357	40.1	40.1	40.1
	Mashkull	534	59.9	59.9	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 1 Përbërja gjinore e studentëve



Përfaqësimi sipas programeve të studimit

Në anketë kanë marrë pjesë studentë nga të gjitha programet e studimit në ciklin e parë dhe të dytë, duke përfshirë programe bachelor dhe master. Pjesëmarrja e tyre është në përputhje të drejtë me numrin aktual të studentëve në secilin program, duke garantuar kështu një vlerësim të gjerë dhe objektiv të përvojës dhe perceptimeve në institucion. Ky nivel i lartë përfaqësimi siguron që rezultatet të reflektojnë më saktë realitetin dhe të ofrojnë bazë të fortë për analizë dhe përmirësime të mëtejshme.

Programi i studimit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	BA në "Informatike Ekonomike" (anglisht)	38	4.3	4.3	4.3
	BA në "Informatikë Ekonomike" (shqip)	89	10.0	10.0	14.3
	BA në "Inteligjencë Artificiale";	21	2.4	2.4	16.6
	BA në "Inxhinieri Kompjuterike";	99	11.1	11.1	27.7
	BA në "Inxhinieri Ndërtimi";	81	9.1	9.1	36.8
	BA në "Inxhinieri Software" (anglisht);	118	13.2	13.2	50.1
	BA në Administrim Biznesi me profile: "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion";	39	4.4	4.4	54.4
	BA në Financë me dy profile: "Kontabilitet", "FinTech";	12	1.3	1.3	55.8
	BA në Inxhinieri Elektrike me profile: "Sistemet e fuqisë", "Elektronikë", "Komuniki me dixhitale", "Kontroll inxhinierik", "Makineri elektrike";	52	5.8	5.8	61.6
	Doktoratë në "Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente"	3	.3	.3	62.0
	MSc në "Artificial Intelligence"	18	2.0	2.0	64.0
	MSc në "Business Analytics & Artificial Intelligence"	12	1.3	1.3	65.3
	MSc në "Ekonomik – MBA";	9	1.0	1.0	66.3
	MSc në "Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku"	25	2.8	2.8	69.1
	MSc në "Inxhinieri Informatike";	7	.8	.8	69.9
	MSc në "Inxhinieri Software";	9	1.0	1.0	70.9
	MSc në "Menaxhim në Inxhinieri";	15	1.7	1.7	72.6
	MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile: "Inxhinieri Strukturash", "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti";	78	8.8	8.8	81.4

	Master në Inxhinieri Elektrike me dy profile: "Energjetikë", "Automatizim Industrie"	18	2.0	2.0	83.4
	Master Profesional në "Marketing Dixhital";	4	.4	.4	83.8
	Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë	73	8.2	8.2	92.0
	Program Profesional në "Dizajn dhe Zhvillim Software";	25	2.8	2.8	94.8
	Program Profesional në "Grafik Dizajn"	22	2.5	2.5	97.3
	Program profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente";	22	2.5	2.5	99.8
	Program Profesional në "Topografi dhe GIS"	2	.2	.2	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 2 Përfaqësimi sipas programeve të studimit

I. SHËRBIMET INFORMATIVE DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT TË REGJISTRIMIT

Kënaqësia me përvojën e regjistrimit në programin e studimit

Nga 891 studentë pjesëmarrës, 666 prej tyre (rreth 75%) kanë shprehur një kënaqësi të lartë me përvojën e regjistrimit në programin e studimit, duke zgjedhur vlerësimet 4 dhe 5. Konkretnisht, 442 studentë (49.6%) janë plotësisht të kënaqur, ndërsa 224 studentë (25.1%) janë kryesisht të kënaqur. Në anën tjetër, 73 studentë (8.2%) shprehen pakënaqësi me notat 1 dhe 2, dhe 152 studentë (17.1%) kanë një qëndrim neutral. Kjo tregon se procesi i regjistrimit është përgjithësisht efektiv dhe i mirëpritur, megjithatë *sugjerohet që të vazhdohet përmirësimi i mëtejshëm për të adresuar shqetësimet e grupit me pakënaqësi dhe për të reduktuar neutralitetin.*

Jam i kënaqur me përvojën time të regjistrimit në programin e studimit që studioj					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	37	4.2	4.2	4.2
	2	36	4.0	4.0	8.2
	3	152	17.1	17.1	25.3
	4	224	25.1	25.1	50.4
	5	442	49.6	49.6	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 3 Kënaqësia me përvojën e regjistrimit në programin e studimit

Regjistrimi i lëndëve semestrale

Nga 891 studentë të anketuar, 713 prej tyre (rreth 80%) janë shprehur pozitivisht për qartësinë dhe lehtësinë e procesit të regjistrimit të lëndëve semestrale, duke zgjedhur vlerësimet 4 dhe 5. Në këtë grup, 541 studentë (60.7%) janë plotësisht të kënaqur, ndërsa 172 studentë (19.3%) tregojnë kënaqësi të konsiderueshme. Një pjesë më e vogël prej 67 studentësh (7.5%) shprehin pakënaqësi (nota 1 dhe 2), ndërsa 111 studentë (12.5%) kanë një qëndrim neutral. Për të siguruar një përvojë sa më të mirë, *sugjerohet rritja e komunikimit dhe asistencës gjatë procesit për grupet me vështirësi.*

Regjistrimi i lëndëve semestrale kryhet në mënyrë të qartë dhe pa komplikime					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	29	3.3	3.3	3.3
	2	38	4.3	4.3	7.5
	3	111	12.5	12.5	20.0
	4	172	19.3	19.3	39.3
	5	541	60.7	60.7	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 4 Regjistrimi i lëndëve semestrale

Efikasiteti i shërbimit për lëshimin e dokumenteve studentore

Një pjesë e konsiderueshme e studentëve, konkretisht 645 nga 891 (rreth 72.1%), janë shprehur pozitivisht për shpejtësinë dhe efikasitetin e shërbimit për lëshimin e dokumenteve si vërtetimet dhe transkriptet, me 445 studentë (49.9%) që janë plotësisht të kënaqur dhe 195 (21.9%) që kanë dhënë një vlerësim pozitiv. Nga ana tjetër, një grup prej 164 studentësh (18.4%) kanë marrë një qëndrim neutral, ndërsa 87 studentë (9.8%) kanë shprehur pakënaqësi. *Përmirësime të mëtejshme në proceset administrative mund të ndihmojnë në rritjen e kënaqësisë dhe reduktimin e vonesave të mundshme.*

Shërbimi për lëshimin e dokumenteve të studentit, si vërtetimet dhe transkriptet, është i shpejtë dhe efikas					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	50	5.6	5.6	5.6
	2	37	4.2	4.2	9.8
	3	164	18.4	18.4	28.2
	4	195	21.9	21.9	50.1
	5	445	49.9	49.9	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 5 Efikasiteti i shërbimit për lëshimin e dokumenteve studentore

Mjaftueshmëria e informacionit në faqen e internetit të institucionit

Shumica dërrmuese e studentëve (680 nga 891, ose rreth 76.3%) vlerësojnë pozitivisht informacionin që ofron faqja e internetit të institucionit për orarin mësimor, regjistrimet dhe aktivitetet akademike e sociale. Në këtë grup, 443 studentë (49.7%) janë plotësisht të kënaqur dhe 237 studentë (26.6%) japin vlerësim pozitiv. Një pjesë prej 131 studentësh (14.7%) kanë një qëndrim neutral, ndërsa 80 studentë (8.9%) shprehin pakënaqësi. *Përpyekjet e mëtejshme për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të informacionit do të jenë të vlefshme për të përmbushur nevojat e ndryshme të përdoruesve.*

Faqja e internetit e institucionit ofron informacion të mjaftueshëm mbi orarin mësimor, regjistrimet dhe aktivitetet akademike e sociale					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	31	3.5	3.5	3.5
	2	49	5.5	5.5	9.0
	3	131	14.7	14.7	23.7
	4	237	26.6	26.6	50.3
	5	443	49.7	49.7	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 6 Mjaftueshmëria e informacionit në faqen e internetit të institucionit

Përfundime mbi vlerësimin e shërbimeve administrative dhe informuese për studentët

Në përgjithësi, shumica e studentëve janë të kënaqur me shërbimet administrative dhe informuese që ofron institucioni. Rreth 75% e tyre vlerësojnë pozitivisht përvojën e regjistrimit në programet e studimit, duke theksuar një proces kryesisht efikas dhe transparent. Regjistrimi i lëndëve semestrale gjithashtu konsiderohet i qartë dhe pa komplikime nga rreth 80% e studentëve, duke reflektuar një organizim të mirë administrativ.

Sa i përket shërbimeve për lëshimin e dokumenteve si vërtetimet dhe transkriptet, mbi 72% janë të kënaqur me shpejtësinë dhe efikasitetin, megjithëse ka hapësirë për përmirësim në reduktimin e vonesave.

Për më tepër, faqja e internetit e institucionit përmendet si një burim i besueshëm dhe i mjaftueshëm informacioni nga rreth 76% e studentëve, duke ndihmuar në orientimin për çështjet akademike dhe sociale.

Për të ruajtur dhe rritur këto nivele pozitive, rekomandohet të vazhdohet përmirësimi i asistencës gjatë regjistrimeve dhe optimizimi i shërbimeve administrative, si dhe të theksohet përditësimi dhe përdorshmëria e faqes online për të adresuar nevojat e përdoruesve në mënyrë sa më efektive.

II. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE MJEDISET FIZIKE

Higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta të institucionit

Nga 891 studentë, rreth 76.4% kanë dhënë vlerësime pozitive për higjienën dhe pastërtinë në tualete, korridore dhe klasa. Konkretisht, 33.2% janë plotësisht të kënaqur dhe 43.2% kryesisht të kënaqur. Një pjesë prej 20% kanë shprehur qëndrim neutral, ndërsa 8.8% kanë shfaqur pakënaqësi. Ky rezultat tregon një perceptim përgjithësisht pozitiv për kushtet higjienike në institucion. *Përmirësimet e mëtejshme mund të synojnë forcimin e monitorimit dhe mirëmbajtjes, për të rritur kënaqësinë e përgjithshme të studentëve.*

Higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta të institucionit (tualet, korridore dhe klasa) është e kënaqshme					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	43	4.8	4.8	4.8
	2	36	4.0	4.0	8.9
	3	131	14.7	14.7	23.6
	4	385	43.2	43.2	66.8
	5	296	33.2	33.2	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 7 Higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta të institucionit

Hapësira dhe ambienti në klasa dhe laboratorë

Nga 891 studentë, 629 prej tyre (rreth 71%) kanë dhënë vlerësime pozitive për hapësirën dhe ambientin në klasa dhe laboratorë, ku 415 studentë (46.6%) janë plotësisht të kënaqur dhe 214 studentë (24%) të kënaqur. Një grup prej 168 studentësh (18.9%) mbajnë qëndrim neutral, ndërsa 94 studentë (rreth 10.5%) shprehin pakënaqësi. Kjo tregon një perceptim kryesisht pozitiv mbi kushtet fizike të mësim. *Sugjerohet thellimi i përpjekjeve për të përmirësuar kushtet, në mënyrë që të adresohen edhe nevojat e atyre që janë më pak të kënaqur.*

Klasat dhe mjediset laboratorike ofrojnë hapësirë të mjaftueshme dhe një ambient të përshtatshëm për mësim efektiv					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	50	5.6	5.6	5.6
	2	44	4.9	4.9	10.5
	3	168	18.9	18.9	29.4
	4	214	24.0	24.0	53.4
	5	415	46.6	46.6	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 8 Hapësira dhe ambienti në klasa dhe laboratorë

Përshtatshmëria e infrastrukturës teknologjike për nevojat e studentëve

Në këtë pyetje, 661 studentë nga 891 (rreth 74%) kanë vlerësuar pozitivisht infrastrukturën teknologjike të UMT-së, duke përfshirë internetin, tabelat interaktive dhe kompjuterët, me 482 studentë (54.1%) plotësisht të kënaqur dhe 179 studentë (20.1%) të kënaqur. Një grup prej 129 studentësh (14.5%) mbajnë qëndrim neutral, ndërsa 101 studentë (rreth 11.3%) shprehin pakënaqësi. Ky rezultat tregon një perceptim të fortë për cilësinë e infrastrukturës, megjithatë vazhdimi i investimeve dhe përmirësimeve do të ndihmojë në rritjen e kënaqësisë së përgjithshme.

Infrastruktura teknologjike e UMT (internet, tabela interaktive, kompjuterët, etj.) plotëson nevojat e mia si student					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	54	6.1	6.1	6.1
	2	47	5.3	5.3	11.3
	3	129	14.5	14.5	25.8
	4	179	20.1	20.1	45.9
	5	482	54.1	54.1	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 9 Përshtatshmëria e infrastrukturës teknologjike për nevojat e studentëve

Kënaqësia me burimet dhe shërbimet e bibliotekës

Nga 891 studentë, 586 prej tyre (rreth 66%) kanë dhënë vlerësime pozitive për burimet dhe shërbimet që ofron biblioteka, ku 431 studentë (48.4%) janë plotësisht të kënaqur dhe 155 të tjerë (17.4%) të kënaqur. Një pjesë prej 201 studentësh (22.6%) shprehin një qëndrim neutral, ndërsa 104 studentë (rreth 11.7%) shprehin pakënaqësi. *Rekomandohet që të forcohet oferta e burimeve dhe shërbimeve bibliotekare për të rritur përvojën studimore dhe për të adresuar nevojat e grupeve me pakënaqësi.*

Jam i kënaqur me burimet dhe shërbimet që ofron biblioteka për mbështetjen e studimeve të mia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	56	6.3	6.3	6.3
	2	48	5.4	5.4	11.7
	3	201	22.6	22.6	34.2
	4	155	17.4	17.4	51.6
	5	431	48.4	48.4	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 10 Kënaqësia me burimet dhe shërbimet e bibliotekës

Përfundime mbi infrastrukturën fizike dhe teknologjike në UMT

Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e studentëve janë përgjithësisht të kënaqur me kushtet fizike dhe teknologjike në UMT. Rreth 76.4% e tyre vlerësojnë pozitivisht higjienën dhe pastërtinë në ambientet e përbashkëta si tualetet, korridoret dhe klasat, ku 33.2% janë plotësisht të kënaqur. Një perceptim kryesisht pozitiv vërehet edhe për hapësirën dhe ambientin në klasa dhe laboratorë, me rreth 71% që shprehin kënaqësi, megjithëse një grup prej 10.5% shprehin pakënaqësi, duke nënvizuar nevojën për përmirësime të mëtejshme në këto hapësira.

Në lidhje me infrastrukturën teknologjike, 74% e studentëve shprehin kënaqësi me pajisjet dhe sistemet që ofron UMT, duke përfshirë internetin dhe pajisjet teknologjike, me 54.1% plotësisht të kënaqur. Kjo tregon një nivel të lartë besimi në kapacitetin teknologjik të universitetit, megjithatë vazhdimi i përditësimeve do të ishte i dobishëm për të rritur kënaqësinë edhe më tej.

Sa i përket burimeve bibliotekare, 66% e studentëve janë pozitivë ndaj shërbimeve dhe materialeve të ofruara, me një përqindje të konsiderueshme që shprehin kënaqësi të plotë. Megjithatë, një pjesë prej 11.7% shpreh pakënaqësi, duke treguar se mund të ketë hapësirë për përmirësim në këtë sektor.

Rekomandohet që institucioni të vazhdojë përpjekjet për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e infrastrukturës fizike dhe teknologjike.

III. CILËSIA AKADEMIKE DHE MËSIMDHËNIA

Përputhshmëria e programit me interesat akademike

Një shumicë e theksuar prej 712 studentësh nga 891, që përbën rreth 80%, shprehen të kënaqur me përputhshmërinë e programit të studimit me interesat dhe objektivat e tyre akademike. Konkretisht, 536 studentë (60.2%) janë plotësisht dakord, ndërsa 176 studentë (19.8%) janë kryesisht dakord me këtë pohim. Një grup prej 116 studentësh (13%) kanë qëndrim neutral, ndërsa 63 studentë (rreth 7.1%) kanë shprehur pakënaqësi me këtë aspekt. Ky rezultat tregon një nivel të lartë përshtatjeje të programeve me pritshmëritë e studentëve, çka është thelbësore për angazhimin dhe motivimin e tyre gjatë studimeve. *Për të përmirësuar edhe më tej këtë aspekt, do të ishte e dobishme të vazhdohet përfshirja e studentëve në rishikimin dhe zhvillimin e programeve, duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e tyre akademike.*

Programi i studimit që kam zgjedhur përputhet me interesat dhe objektivat e mia akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	30	3.4	3.4	3.4
	2	33	3.7	3.7	7.1
	3	116	13.0	13.0	20.1
	4	176	19.8	19.8	39.8
	5	536	60.2	60.2	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 11 Përputhshmëria e programit me interesat akademike

Raporti mes numrit të pedagogëve dhe studentëve

Shumica e studentëve, 737 nga 891 (rreth 83%), janë dakord se raporti mes numrit të pedagogëve dhe studentëve është i përshtatshëm. Konkretisht, 517 studentë (58%) janë plotësisht dakord dhe 220 (24.7%) janë kryesisht dakord me këtë pohim. Një pjesë prej 96 studentësh (10.8%) kanë një qëndrim neutral, ndërsa 58 studentë (6.5%) shprehën pakënaqësi.

Ky perceptim pozitiv tregon besimin në kapacitetin e stafit akademik për të përmbushur nevojat e studentëve në procesin mësimor. *Për të ruajtur këtë nivel, rekomandohet monitorimi i vazhdueshëm i raportit dhe, sipas nevojës, rritja e stafit akademik për të siguruar cilësi optimale në mësimdhënie.*

Mendoj se ka një raport të përshtatshëm midis numrit të pedagogëve dhe numrit të studentëve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	28	3.1	3.1	3.1
	2	30	3.4	3.4	6.5
	3	96	10.8	10.8	17.3
	4	220	24.7	24.7	42.0
	5	517	58.0	58.0	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 12 Raporti mes numrit të pedagogëve dhe studentëve

Mbështetja shtesë nga pedagogët jashtë orarit të mësimit

Nga 891 studentë, 693 prej tyre (rreth 77.7%) kanë dhënë vlerësime pozitive për gatishmërinë e pedagogëve për të ofruar mbështetje jashtë orarit të mësimit. Konkretisht, 551 studentë (61.8%) janë plotësisht të kënaqur dhe 142 (15.9%) janë kryesisht të kënaqur. Një grup prej 128 studentësh (14.4%) kanë qëndrim neutral, ndërsa 70 studentë (7.9%) shprehen pakënaqësi.

Ky rezultat tregon një perceptim pozitiv për përkushtimin e stafit akademik për të mbështetur studentët jashtë orarit zyrtar. Për të rritur më tej këtë mbështetje, sugjerohet nxitja e komunikimit dhe ofrimi i orareve fleksibël konsultimi, për të përfshirë sa më shumë studentë që kanë nevojë.

Pedagogët janë të gatshëm të japin mbështetje shtesë jashtë orarit të mësimit kur kam pyetje ose kam nevojë për ndihmë akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	37	4.2	4.2	4.2
	2	33	3.7	3.7	7.9
	3	128	14.4	14.4	22.2
	4	142	15.9	15.9	38.2
	5	551	61.8	61.8	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 13 Mbështetja shtesë nga pedagogët jashtë orarit të mësimit

Mbështetja e këshillimit akademik

Në lidhje me procesin e këshillimit akademik, 659 studentë nga 891 (rreth 74%) kanë dhënë vlerësime pozitive, ku 439 studentë (49.3%) janë plotësisht të kënaqur dhe 220 (24.7%) shprehen kryesisht të kënaqur. Një pjesë prej 159 studentësh (17.8%) kanë qëndrim neutral, ndërsa 73

studentë (8.2%) kanë shprehur pakënaqësi.

Kjo tregon se këshillimi akademik perceptohet si një mbështetje e rëndësishme për zhvillimin akademik të studentëve. *Për të përmirësuar më tej këtë shërbim, do të ishte e dobishme të intensifikohet ndërveprimi individual dhe të rritet qasja ndaj këshillimit personal.*

Procesi i këshillimit akademik siguron mbështetjen e nevojshme për përparimin tim akademik					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	32	3.6	3.6	3.6
	2	41	4.6	4.6	8.2
	3	159	17.8	17.8	26.0
	4	220	24.7	24.7	50.7
	5	439	49.3	49.3	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 14 Mbështetja e këshillimit akademik

Efikasiteti i komunikimit me administratën dhe pedagogët

Shumica e studentëve, 706 nga 891 (rreth 79%), janë shprehur pozitivisht për komunikimin me administratën dhe pedagogët, ku 556 studentë (62.4%) janë plotësisht të kënaqur dhe 150 (16.8%) tregojnë kënaqësi të konsiderueshme. Një grup prej 116 studentësh (13%) janë neutralë, ndërsa 69 studentë (7.7%) kanë shprehur pakënaqësi.

Ky rezultat tregon një perceptim pozitiv mbi organizimin dhe shpejtësinë e komunikimit brenda institucionit. *Për të avancuar cilësinë e këtij komunikimi, do të ishte e vlefshme të inkurajohet një vëmendje edhe më e madhe ndaj përgjigjeve të shpejta dhe efektive për të gjithë studentët.*

Komunikimi me administratën dhe pedagogët është i strukturuar dhe i shpejtë					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	35	3.9	3.9	3.9
	2	34	3.8	3.8	7.7
	3	116	13.0	13.0	20.8
	4	150	16.8	16.8	37.6
	5	556	62.4	62.4	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 15 Efikasiteti i komunikimit me administratën dhe pedagogët

Organizimi i aktiviteteve jashtë kurrikulare për zhvillim profesional

Rreth 69% e studentëve (633 nga 891) kanë vlerësuar pozitivisht organizimin e aktiviteteve jashtë kurrikulare që ndihmojnë në zhvillimin e tyre profesional, ku 448 studentë (50.3%) janë plotësisht të kënaqur dhe 185 (20.8%) tregojnë kënaqësi të konsiderueshme. Një pjesë prej 149 studentësh (16.7%) janë neutralë, ndërsa 109 studentë (12.3%) kanë shprehur pakënaqësi.

Kjo tregon një prani të mirë të këtyre aktiviteteve në institucion, megjithëse *mund të jetë e dobishme të eksplorohe mënyra për të rritur pjesëmarrjen dhe ndikimin e tyre në zhvillimin profesional të studentëve.*

Institucioni organizon aktivitete jashtë kurrikulare që më ndihmojnë në zhvillimin tim profesional					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	47	5.3	5.3	5.3
	2	62	7.0	7.0	12.2
	3	149	16.7	16.7	29.0
	4	185	20.8	20.8	49.7
	5	448	50.3	50.3	100.0
Total		891	100.0	100.0	

Tabela 16 Organizimi i aktiviteteve jashtë kurrikulare për zhvillim profesional

Mundësitë për praktika profesionale dhe përvojë pune

Nga 891 studentë, 649 prej tyre (rreth 73%) kanë dhënë vlerësime pozitive për mundësitë që programi i studimit ofron për praktika profesionale, me 514 studentë (57.7%) plotësisht të kënaqur dhe 135 (15.2%) që shprehin kënaqësi. Një grup prej 127 studentësh (14.3%) janë neutralë, ndërsa 115 studentë (12.9%) shprehin pakënaqësi.

Ky rezultat tregon se programi krijon një bazë të mirë për përvojën praktike, megjithatë *është e rëndësishme të intensifikohen përpjekjet për të përmirësuar dhe zgjeruar ofertat e praktikave profesionale, në mënyrë që të përfshihen më shumë studentë dhe të rritet cilësia e përvojës së fituar.*

Programi ofron mundësi të vlefshme për praktika profesionale që më ndihmojnë të fitoj përvojë reale pune					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	66	7.4	7.4	7.4

	2	49	5.5	5.5	12.9
	3	127	14.3	14.3	27.2
	4	135	15.2	15.2	42.3
	5	514	57.7	57.7	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 17 Mundësitë për praktika profesionale dhe përvojë pune

Përfundime mbi cilësinë akademike dhe mbështetjen në UMT

Nga 891 studentë të anketuar, rreth 80% janë të kënaqur me përputhshmërinë e programit të studimit me interesat dhe objektivat e tyre akademike, ku 536 prej tyre (60.2%) janë plotësisht dakord. Një perceptim i ngjashëm pozitiv vjen edhe për raportin mes numrit të pedagogëve dhe studentëve, ku 737 studentë (83%) e konsiderojnë të përshtatshëm këtë raport, duke theksuar besimin në kapacitetin e stafit akademik.

Mbështetja jashtë orarit të mësimit nga pedagogët është vlerësuar pozitivisht nga 693 studentë (77.7%), duke treguar përkushtimin e stafit akademik për t'u përgjigjur nevojave individuale të studentëve. Po ashtu, 659 studentë (74%) shprehin kënaqësi me procesin e këshillimit akademik, i cili konsiderohet si mbështetje e rëndësishme për përparimin studimor.

Në aspektin e komunikimit, 706 studentë (79%) vlerësojnë pozitivisht organizimin dhe shpejtësinë e komunikimit me administratën dhe pedagogët, duke reflektuar një sistem efikas dhe funksional. Në lidhje me zhvillimin profesional jashtë kurrikulës, 633 studentë (69%) e vlerësojnë mirë organizimin e aktiviteteve, megjithëse ka mundësi për të rritur pjesëmarrjen dhe ndikimin e këtyre aktiviteteve.

Sa i përket praktikave profesionale, 649 studentë (73%) janë të kënaqur me mundësitë e ofruara për të fituar përvojë reale pune. *Përmirësimi i ofertës së praktikave dhe rritja e përfshirjes së studentëve do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së përvojës praktike.*

Ky grup rezultatesh tregon një perceptim të përgjithshëm pozitiv për cilësinë akademike dhe mbështetjen që UMT ofron, duke theksuar nevojën për përmirësime të vazhdueshme në disa fusha për të rritur kënaqësinë dhe angazhimin e studentëve.

IV. PËRGATITJA PROFESIONALE DHE AVANTAZHET KONKURRUESE

Kënaqësia me zgjedhjen e UMT-së si institucion studimi

Nga 891 studentë që morën pjesë në anketë, 656 prej tyre (73.6%) shprehën kënaqësi me zgjedhjen e Universitetit Metropolitan Tirana si institucionin e tyre të studimeve. Konkretisht, 342 studentë (38.4%) janë kryesisht të kënaqur dhe 314 studentë (35.2%) plotësisht të kënaqur me këtë vendim. Një pjesë prej 142 studentësh (15.9%) mbajnë një qëndrim neutral, ndërsa 93 studentë (10.4%) shprehën pakënaqësi për këtë çështje.

Ky rezultat reflekton një perceptim kryesisht pozitiv dhe besim në institucion, duke treguar që shumica e studentëve ndihen mirë dhe të motivuar nga zgjedhja e bërë. *Për të rritur më tej kënaqësinë dhe për të minimizuar pakënaqësitë, do të ishte e dobishme të merren parasysh nevojat dhe pritshmëritë e grupeve që shprehin dyshime ose rezervë.*

Jam i kënaqur që kam zgjedhur UMT si institucionin tim të studimeve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	43	4.8	4.8	4.8
	2	50	5.6	5.6	10.4
	3	142	15.9	15.9	26.4
	4	342	38.4	38.4	64.8
	5	314	35.2	35.2	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 18 Kënaqësia me zgjedhjen e UMT-së si institucion studimi

Kënaqësia për kushtet e ofruara në UMT në krahasim me pritshmëritë fillestare

Në këtë pyetje, 551 studentë nga 891 (rreth 62%) kanë vlerësuar pozitivisht që kushtet e ofruara nga UMT kanë tejkaluar pritshmëritë e tyre fillestare, me 414 studentë (46.5%) plotësisht të kënaqur dhe 137 studentë (15.4%) kryesisht të kënaqur. Një pjesë prej 225 studentësh (25.3%) shprehin qëndrimin neutral, që mund të interpretohet si përputhje me pritshmëritë, pa tejkalim të dukshëm. Vetëm 115 studentë (12.9%) kanë shprehur pakënaqësi, duke treguar që një grup i vogël nuk e ka përmbushur plotësisht pritshmërinë për kushtet.

Ky rezultat tregon se shumica e studentëve ndihen të kënaqur dhe madje të surprizuar pozitivisht nga kushtet e ofruara, ndërsa neutraliteti tregon që kushtet janë në përputhje me pritshmëritë për shumicën tjetër.

Kushtet e ofruara në UMT kanë tejkaluar pritshmëritë e mia fillestare					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	50	5.6	5.6	5.6
	2	65	7.3	7.3	12.9
	3	225	25.3	25.3	38.2
	4	137	15.4	15.4	53.5
	5	414	46.5	46.5	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 19 Kënaqësia për kushtet e ofruara në UMT në krahasim me pritshmëritë fillestare

Aftësitë në gjuhë të huaja si avantazh profesional

Nga 891 studentë, 629 prej tyre (rreth 70.6%) vlerësojnë pozitivisht që aftësitë në gjuhë të huaja të fituara në UMT përbëjnë një avantazh për karrierën e tyre. Konkretisht, 391 studentë (43.9%) janë plotësisht dakord dhe 238 (26.7%) kryesisht dakord me këtë pohim. Një grup prej 169 studentësh (19%) kanë qëndrim neutral, ndërsa 93 studentë (10.4%) shprehin pakënaqësi, duke reflektuar rezervat ose mungesën e qartësisë mbi përfitimet nga këto aftësi.

Duke pasur parasysh se UMT ofron programe në gjuhën angleze dhe anglishtja është pjesë integrale e kurrikulës, rekomandohet që institucioni të rrisë ndërgjegjësimin për këto mundësi. Kjo mund të realizohet përmes fushatave informuese dhe orientimeve të dedikuara, duke nxitur studentët të shfrytëzojnë maksimalisht programet dhe resurset gjuhësore që u ofrohen, duke përmirësuar kështu aftësitë e tyre dhe përgatitjen për tregun ndërkombëtar të punës.

Aftësitë në gjuhë të huaja të fituara në këtë institucion përbëjnë një avantazh profesional për karrierën time					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	52	5.8	5.8	5.8
	2	41	4.6	4.6	10.4
	3	169	19.0	19.0	29.4
	4	238	26.7	26.7	56.1
	5	391	43.9	43.9	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 20 Aftësitë në gjuhë të huaja si avantazh profesional

Tarifat financiare të programit

Nga 891 studentë, 543 prej tyre (rreth 61%) kanë dhënë vlerësime pozitive për arsyeshmërinë dhe përballueshmërinë e tarifave të programit, me 390 studentë (43.8%) që janë plotësisht dakord dhe 153 (17.2%) që janë kryesisht dakord. Një pjesë prej 239 studentësh (26.8%) mbajnë qëndrim neutral, ndërsa 109 studentë (12.2%) kanë shprehur pakënaqësi lidhur me këtë çështje.

Tarifat financiare të programit janë të arsyeshme dhe të përballueshme për mua					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	52	5.8	5.8	5.8
	2	57	6.4	6.4	12.2
	3	239	26.8	26.8	39.1
	4	153	17.2	17.2	56.2
	5	390	43.8	43.8	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 21 Tarifat financiare të programit

Përmbledhje e kënaqësisë së studentëve mbi përgatitjen profesionale dhe kushtet në UMT

Një shumicë e konsiderueshme prej 73.6% e studentëve shprehin kënaqësi me zgjedhjen e Universitetit Metropolitan Tirana si institucionin e tyre të studimeve. Ky rezultat tregon besim dhe motivim të lartë midis studentëve.

Përsa i përket kushteve të ofruara nga UMT, rreth 62% e studentëve vlerësojnë se ato kanë tejkaluar pritshmëritë fillestare, ndërsa 25.3% i konsiderojnë kushtet në përputhje me pritshmëritë. Një grup prej 12.9% shpreh pakënaqësi, duke treguar se disa nevoja duhet adresuar për të përmirësuar ambientin dhe shërbimet.

Rreth 70.6% e studentëve e konsiderojnë aftësinë në gjuhë të huaja si një avantazh profesional të fituar në UMT. Duke pasur parasysh programet në gjuhën angleze dhe rëndësinë e anglishtes në kurrikulë, rekomandohet rritja e ndërgjegjësimit për këto mundësi, përmes fushatave informuese dhe mbështetjes së orientimit gjuhësor.

Në lidhje me tarifat financiare, rreth 61% e studentëve i vlerësojnë ato si të arsyeshme dhe të

përballueshme, megjithëse 12.2% kanë shprehur pakënaqësi, çka tregon nevojën për komunikim më të qartë rreth politikave tarifore dhe mbështetje financiare për studentët në nevojë.

Këto rezultate tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv për përgatitjen profesionale dhe kushtet në UMT, me disa fusha ku rekomandohet përmirësim për të rritur më tej kënaqësinë dhe përfshirjen e studentëve.

V. JETA SOCIALE DHE MJEDISI STUDENTOR

Mjediset sociale dhe përvoja studentore në UMT

Nga 891 studentë, rreth 51.4% kanë vlerësuar pozitivisht mjediset sociale që institucioni ofron dhe ndikimin e tyre në jetën studentore, ku 28.7% janë plotësisht të kënaqur dhe 22.7% kryesisht të kënaqur. Një pjesë e konsiderueshme, 38%, kanë shprehur një qëndrim neutral, ndërsa 10.6% kanë shfaqur pakënaqësi.

Ky rezultat tregon se mjediset sociale pranë UMT-së kanë një ndikim përgjithësisht pozitiv, por ka ende hapësirë për zhvillim për të përfshirë më shumë studentë dhe për të përmirësuar ofertën në këtë fushë. *Rekomandohet që institucioni të vazhdojë të krijojë dhe promovojë iniciativa sociale dhe kulturore që përforcojnë lidhjen mes studentëve dhe krijojnë një ambient më mbështetës dhe motivues.*

Institucioni ofron mjedise sociale që kontribuojnë pozitivisht në jetën time studentore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	40	4.5	4.5	4.5
	2	54	6.1	6.1	10.5
	3	339	38.0	38.0	48.6
	4	202	22.7	22.7	71.3
	5	256	28.7	28.7	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 22 Mjediset sociale dhe përvoja studentore në UMT

Aktivitetet sociale dhe kulturore në UMT

Nga 891 studentë, 70.6% kanë dhënë vlerësime pozitive për aktivitetet sociale dhe kulturore që organizon institucioni, ku 24.1% janë plotësisht të kënaqur dhe 46.5% kryesisht të kënaqur me këto aktivitete. Një pjesë prej 19.1% kanë shprehur qëndrim neutral, ndërsa 10.4% kanë shfaqur pakënaqësi.

Ky tregues tregon se aktivitetet kulturore dhe sociale kontribuojnë ndjeshëm në pasurimin e përvojës studentore. *Për të rritur edhe më shumë pjesëmarrjen dhe kënaqësinë, rekomandohet promovimi i mëtejshëm i këtyre aktiviteteve dhe përfshirja e interesave të ndryshme të studentëve*

në programimin e tyre.

Institucioni zhvillon aktivitete sociale dhe kulturore që e pasurojnë përvojën time studentore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	38	4.3	4.3	4.3
	2	54	6.1	6.1	10.3
	3	170	19.1	19.1	29.4
	4	414	46.5	46.5	75.9
	5	215	24.1	24.1	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 23 Aktivitetet sociale dhe kulturore në UMT

Promovimi i diversitetit dhe përfshirjes sociale

Shumica dërmuese e studentëve në UMT, rreth 75.3%, kanë vlerësuar pozitivisht aktivitetet që zhvillon institucioni për të promovuar diversitetin dhe përfshirjen sociale gjatë vitit akademik. Konkretisht, 66.9% janë kryesisht të kënaqur dhe 8.4% plotësisht të kënaqur. Një pjesë prej 15.9% kanë një qëndrim neutral, ndërsa vetëm 8.8% shprehin pakënaqësi.

Ky rezultat tregon angazhimin e mirë të institucionit për të krijuar një ambient të përfshirjes dhe respektit për të gjitha grupet studentore. *Për të forcuar këtë përkushtim, rekomandohet të vazhdohet nxitja e aktiviteteve gjithëpërfshirëse dhe komunikimi i qartë mbi mundësitë që ofrohen për të gjithë studentët.*

Përgjatë vitit akademik, institucioni zhvillon aktivitete që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale midis studentëve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	39	4.4	4.4	4.4
	2	39	4.4	4.4	8.8
	3	142	15.9	15.9	24.7
	4	596	66.9	66.9	91.6
	5	75	8.4	8.4	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 24 Promovimi i diversitetit dhe përfshirjes sociale

Kënaqësia nga shërbimet mjekësore

Rreth 56.2% e studentëve të anketuar janë shprehur pozitivisht për shërbimet mjekësore që ofron UMT, me 26.8% plotësisht të kënaqur dhe 29.4% kryesisht të kënaqur. Një pjesë e konsiderueshme prej 32.8% ka marrë një qëndrim neutral, ndërsa 11% kanë shprehur pakënaqësi.

Ky rezultat tregon se shërbimet mjekësore perceptohen si të pranueshme nga shumica, por një grup i rëndësishëm studentësh mbetet neutral ose i pakënaqur. *Rekomandohet të bëhet një vlerësim më i detajuar i shërbimeve për të identifikuar fushat ku mund të përmirësohet cilësia dhe aksesueshmëria e tyre, në mënyrë që të rritet kënaqësia e përgjithshme.*

Jam i kënaqur nga shërbimet mjekësore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	58	6.5	6.5	6.5
	2	40	4.5	4.5	11.0
	3	292	32.8	32.8	43.8
	4	262	29.4	29.4	73.2
	5	239	26.8	26.8	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 25 Kënaqësia nga shërbimet mjekësore

Jeta sociale dhe shërbimet mbështetëse në UMT

Një pjesë e konsiderueshme e studentëve vlerësojnë pozitivisht mjediset sociale dhe aktivitetet kulturore që organizon UMT, duke kontribuar në pasurimin e përvojës së tyre studentore. Konkretisht, rreth 51.4% janë të kënaqur me mjediset sociale, ndërsa 70.6% shprehin kënaqësi për aktivitetet sociale dhe kulturore. Megjithatë, një numër i rëndësishëm studentësh ka qëndrim neutral ose pakënaqësi, duke treguar hapësirë për përmirësim dhe rritje të pjesëmarrjes.

Institucioni gjithashtu nxit diversitetin dhe përfshirjen sociale, ku 75.3% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive, duke reflektuar një angazhim të fortë në krijimin e një ambienti gjithëpërfshirës. Përforsimi i këtyre iniciativave dhe komunikimi i mundësive për të gjithë studentët do të kontribuojnë në rritjen e kënaqësisë.

Sa i përket shërbimeve mjekësore, 56.2% e studentëve shprehin kënaqësi, por një pjesë e konsiderueshme mbetet neutral ose pakënaqur. *Rekomandohet vlerësimi i hollësishëm i cilësisë dhe aksesueshmërisë së shërbimeve shëndetësore për të adresuar nevojat dhe përmirësuar*

përvojën e studentëve.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një klimë sociale dhe institucionale pozitive, megjithëse ka nevojë për vazhdimësi në përmirësime dhe zhvillimin e mëtejshëm të ofertave që ndikojnë në mirëqenien dhe përvojën e studentëve.

VI. PJESEMARRJA STUDENTORE DHE PËRFAQËSIMI

Përfaqësimi i studentëve në organet kolegjiale

Shumica e studentëve, konkretisht 660 nga 891 (rreth 74%), kanë vlerësuar pozitivisht përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale të institucionit. Nga këta, 509 studentë (57.1%) janë plotësisht të kënaqur me këtë aspekt, ndërsa 151 (16.9%) janë kryesisht dakord. Një grup prej 145 studentësh (16.3%) shprehin qëndrim neutral, ndërsa 86 studentë (9.7%) shfaqin pakënaqësi lidhur me përfaqësimin.

Ky tregues pasqyron një nivel të mirë përfshirjeje të studentëve në proceset vendimmarrëse, që është thelbësore për sigurimin e transparencës dhe dialogut institucional. *Për të përmirësuar më tej këtë aspekt, rekomandohet rritja e komunikimit mbi rolin dhe ndikimin e përfaqësuesve studentorë, si dhe ofrimi i mundësive shtesë për pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.*

Studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale të institucionit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	40	4.5	4.5	4.5
	2	46	5.2	5.2	9.7
	3	145	16.3	16.3	25.9
	4	151	16.9	16.9	42.9
	5	509	57.1	57.1	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 26 Përfaqësimi i studentëve në organet kolegjiale

Nxitja dhe hapja ndaj kërkesave të përfaqësuesve studentorë

Nga 891 studentë të anketuar, 670 prej tyre (rreth 75%) kanë vlerësuar pozitivisht qëndrimin e institucionit në nxitjen e kërkesave të përfaqësuesve të studentëve dhe hapjen ndaj sugjerimeve të tyre. Konkretisht, 167 studentë (18.7%) janë plotësisht të kënaqur dhe 503 (56.5%) kryesisht dakord me këtë pohim. Një pjesë prej 142 studentësh (15.9%) kanë qëndrim neutral, ndërsa 79 studentë (8.9%) shprehin pakënaqësi.

Ky perceptim tregon një gatishmëri të konsiderueshme institucionale për të dëgjuar dhe adresuar nevojat e studentëve. *Rekomandohet që të forcohet komunikimi i vazhdueshëm me përfaqësuesit studentorë dhe të krijohen mekanizma të mëtejshëm për përfshirjen e tyre aktive në proceset*

vendimmarrëse.

Institucioni nxit kërkesat e përfaqësuesve të studentëve dhe është i hapur për sugjerimet e tyre					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	38	4.3	4.3	4.3
	2	41	4.6	4.6	8.9
	3	142	15.9	15.9	24.8
	4	503	56.5	56.5	81.3
	5	167	18.7	18.7	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 27 Nxitja dhe hapja ndaj kërkesave të përfaqësuesve studentorë

Përfundim mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin studentor në institucion

Një shumicë e konsiderueshme e studentëve, rreth 74% (660 nga 891), janë të kënaqur me përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale të institucionit, ku 57.1% janë plotësisht të kënaqur dhe 16.9% kryesisht dakord. Megjithatë, 16.3% kanë qëndrim neutral, ndërsa 9.7% shprehin pakënaqësi lidhur me këtë aspekt. Ky rezultat tregon një nivel të mirë të përfshirjes së studentëve në proceset vendimmarrëse, që ndihmon në transparencën dhe dialogun institucional.

Në lidhje me nxitjen dhe hapjen e institucionit ndaj kërkesave dhe sugjerimeve të përfaqësuesve studentorë, 75% e studentëve shprehen pozitivisht. Konkretisht, 18.7% janë plotësisht të kënaqur dhe 56.5% kryesisht dakord, ndërsa 15.9% kanë qëndrim neutral dhe 8.9% pakënaqësi. Kjo tregon një përkushtim të dukshëm të institucionit për të dëgjuar dhe adresuar nevojat e studentëve.

Rekomandohet forcimi i komunikimit të vazhdueshëm me përfaqësuesit studentorë dhe krijimi i mekanizmave të mëtejshëm për përfshirjen e tyre aktive në vendimmarrje, për të rritur efektivitetin dhe përfaqësimin real të studentëve në institucion.

VII. NDJENJA E PËRKATËSISË DHE IMPLIKIMET PËR TË ARDHMEN

Krenaria dhe besimi në diplomën e UMT-së

Shumica dërmuese e studentëve, 639 nga 891 (rreth 72%), ndihen krenarë dhe të sigurt për të ardhmen profesionale për shkak të diplomës së marrë nga Universiteti Metropolitan Tirana. Konkretisht, 53% janë plotësisht të kënaqur dhe 18.7% kryesisht dakord me këtë pohim. Një pjesë prej 17.7% kanë qëndrim neutral, ndërsa 10.5% shprehin pakënaqësi ose dyshime lidhur me këtë temë.

Ky rezultat tregon besimin e fortë që studentët kanë në vlerën dhe reputacionin e diplomës së UMT-së si një pasaportë për sukses në tregun e punës dhe zhvillim profesional. *Për të përforcuar këtë besim dhe krenari, do të ishte e dobishme të vazhdohet promovimi i sukseseve të të diplomuarve dhe të krijohen më shumë lidhje me sektorin profesional për të rritur njohjen e diplomës në nivel lokal dhe ndërkombëtar.*

Diploma e UMT më bën të ndihem krenar dhe të sigurt për të ardhmen time profesionale					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	42	4.7	4.7	4.7
	2	52	5.8	5.8	10.5
	3	158	17.7	17.7	28.3
	4	167	18.7	18.7	47.0
	5	472	53.0	53.0	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 28 Krenaria dhe besimi në diplomën e UMT-së

Krenaria për studimet në UMT

Shumica dërmuese e studentëve, 643 nga 891 (rreth 72%), ndihen krenarë të tregojnë se studiojnë në Universitetin Metropolitan Tirana. Konkretisht, 41.2% janë plotësisht krenarë dhe 31% kryesisht krenarë për këtë fakt. Një grup prej 17.4% kanë një qëndrim neutral, ndërsa 10.4% shprehin rezervë ose pakënaqësi lidhur me këtë. Ky rezultat tregon një nivel të lartë identifikimi dhe krenarie me institucionin, çka kontribuon në ndjenjën pozitive të përkatësisë dhe motivimit akademik. *Për të forcuar këtë ndjenjë, sugjerohet intensifikimi i aktiviteteve promovuese dhe ngjarjeve që rrisin lidhjet e studentëve me universitetin dhe përmirësojnë imazhin e tij në*

komunitet.

Ndihejm krenar kur u them të tjerëve se studioj në UMT					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	42	4.7	4.7	4.7
	2	51	5.7	5.7	10.4
	3	155	17.4	17.4	27.8
	4	276	31.0	31.0	58.8
	5	367	41.2	41.2	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Perceptimi për mundësinë e përfundimit të studimeve në të gjitha nivelet në UMT

Nga 891 studentë, 644 prej tyre (rreth 72%) shprehin besim se Universiteti Metropolitan Tirana ofron mundësinë për të përfunduar studimet në të gjitha nivelet akademike. Konkreisht, 54.7% janë plotësisht dakord dhe 17.6% kryesisht dakord me këtë pohim. Një grup prej 17.5% shfaq qëndrim neutral, ndërsa 10.2% kanë shprehur pakënaqësi ose dyshime.

Ky rezultat pasqyron një perceptim pozitiv dhe besim në ofertën akademike të institucionit, si dhe në mundësitë për vazhdimësi studimore. *Për të forcuar këtë besim, rekomandohet që UMT të vazhdojë komunikimin transparent për ofertat e programeve të ndryshme dhe të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë rrugëtimit akademik.*

UMT është universiteti ku shoh mundësinë për të përfunduar studimet në të gjitha nivelet akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	48	5.4	5.4	5.4
	2	43	4.8	4.8	10.2
	3	156	17.5	17.5	27.7
	4	157	17.6	17.6	45.3
	5	487	54.7	54.7	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 29 Perceptimi për mundësinë e përfundimit të studimeve në të gjitha nivelet në UMT

Sugjerimi i UMT si një nga zgjedhjet më të mira

Shumica e studentëve, 650 nga 891 (rreth 73%), e rekomandojnë Universitetin Metropolitan Tirana si një nga zgjedhjet më të mira për arsimin e tyre. Konkretisht, 54.7% janë plotësisht dakord dhe 18.3% kryesisht dakord me këtë pohim. Një pjesë prej 17.4% kanë qëndrim neutral, ndërsa 9.7% shfaqin pakënaqësi.

Ky tregues reflekton një besim dhe kënaqësi të përgjithshme ndaj cilësisë dhe mundësive që ofron UMT për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. *Për të ruajtur dhe përforcuar këtë imazh pozitiv, rekomandohet që institucioni t'i kushtojë vëmendje të vazhdueshme përmirësimit të vazhdueshëm dhe komunikimit me studentët.*

E sugjeroj UMT si një nga zgjedhjet më të mira					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	42	4.7	4.7	4.7
	2	44	4.9	4.9	9.7
	3	155	17.4	17.4	27.0
	4	163	18.3	18.3	45.3
	5	487	54.7	54.7	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 30 Sugjerimi i UMT si një nga zgjedhjet më të mira

Sugjeroj UMT për edukim cilësor dhe zhvillim

Rreth 73% e studentëve (652 nga 891) shprehin rekomandim pozitiv për UMT-në si një institucion që ofron edukim cilësor dhe mundësi të shkëlqyera për zhvillim profesional. Konkretisht, 55.2% janë plotësisht dakord dhe 18% kryesisht dakord me këtë pohim. Një grup prej 17.1% mban qëndrim neutral, ndërsa 9.8% shprehin pakënaqësi.

Ky rezultat dëshmon se shumica e studentëve besojnë se UMT siguron një ambient edukativ të përshtatshëm dhe mundësi për avancim profesional. *Për të forcuar më tej këtë perceptim, rekomandohet rritja e promovimit të programeve dhe shërbimeve që adresojnë nevojat e ndryshme të studentëve.*

Sugjeroj UMT për ata që kërkojnë një edukim cilësor dhe mundësi të shkëlqyera zhvillimi					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	38	4.3	4.3	4.3
	2	49	5.5	5.5	9.8
	3	152	17.1	17.1	26.8
	4	160	18.0	18.0	44.8

	5	492	55.2	55.2	100.0
	Total	891	100.0	100.0	

Tabela 31 Sugjerorj UMT për edukim cilësor dhe zhvillim

Përfundime mbi ndjenjën e përkatësisë dhe besimit në UMT

Shumica dërrmuese e studentëve të anketuar shprehin krenari dhe besim të fortë në diplomën e Universitetit Metropolitan Tirana dhe në institucionin si tërësi. Rreth 72% ndihen krenarë dhe të sigurt për të ardhmen profesionale, ndërsa një përqindje e ngjashme ndjehen krenarë të tregojnë se studiojnë në UMT. Kjo tregon një lidhje të fuqishme emocionale dhe përkatësi ndaj universitetit, që ndikon pozitivisht në motivimin dhe angazhimin e tyre.

Gjithashtu, mbi 70% e studentëve besojnë se UMT ofron mundësi për të përfunduar studimet në të gjitha nivelet akademike, duke reflektuar besimin në ofertën akademike dhe perspektivat e zhvillimit të vazhdueshëm.

Rekomandohet që UMT të vazhdojë të forcojë komunikimin dhe mbështetjen për studentët gjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik, si dhe të promovojë më tej sukseset dhe vlerat e institucionit për të ruajtur këtë besim të lartë.

Rreth 73% e studentëve rekomandojnë UMT-në si një nga zgjedhjet më të mira për arsimin e tyre, duke theksuar edukimin cilësor dhe mundësitë e shkëlqyera për zhvillim profesional. Kjo pasqyron një perceptim pozitiv të cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve që ofron institucioni.

Për të ruajtur dhe përforcuar këtë imazh pozitiv, sugjerohet të vazhdohet me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve dhe shërbimeve, si dhe intensifikimi i promovimit të tyre për të adresuar nevojat dhe pritshmëritë e të gjithë studentëve.

Ky besim dhe kënaqësi e studentëve është një bazë e fortë për zhvillimin e mëtejshëm të Universitetit Metropolitan Tirana dhe rritjen e reputacionit të tij në komunitetin akademik dhe profesional.

Vlerësimi i komenteve dhe sugjerimeve të studentëve

(Kërkesa: Bëni komente/sugjerimet tuaja më poshtë)

Studentët kanë ndarë mendimet dhe sugjerimet e tyre që reflektojnë përvojën dhe perceptimet mbi universitetin. Përgjithësisht, përgjigjet tregojnë një kënaqësi dhe lidhje pozitive me institucionin, si dhe vullnet për zhvillim e përmirësim në disa fusha të caktuara.

1. Pikë të forta dhe elementë pozitivë:

- Shumë studentë vlerësojnë stafin akademik si të përkushtuar dhe mbështetës, me pedagogë që tregojnë gatishmëri për t'i ndihmuar jashtë orarit.
- Organizimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit marrin vlerësime të mira, si edhe cilësia e mësimdhënies në përgjithësi.
- Komente pozitive janë shprehur për marrëdhëniet e mirë me stafin dhe shërbimet që u ofrohen studentëve.
- Disa studentë përmendin pedagogë të veçantë për punën e tyre cilësore dhe qasjen pozitive.

2. Fushat për përmirësim:

- Në disa komente shfaqen sugjerime për përmirësim të infrastrukturës fizike dhe teknologjike, si laboratorët dhe mjediset sociale, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për studim dhe punë.
- Studentët shprehin dëshirën për më shumë mundësi praktike dhe përfshirje në aktivitete që lidhin teorinë me praktikën profesionale.
- Përmirësimi i komunikimit institucional dhe transparencës në vlerësim është një tjetër aspekt ku disa sugjerojnë të fokusohet më shumë.
- Ka kërkesa të moderuara për shtim të aktiviteteve që fuqizojnë bashkëpunimin midis studentëve dhe stafit, si dhe për menaxhim më të qartë të orareve dhe mungesave.

3. Sugjerime specifike:

- Disa vlerësojnë që organizimi i orareve të provimeve mund të përmirësohet për të reduktuar ngarkesën dhe stresin.
- Përmirësimi i ambientit fizik, si pastrimi dhe mirëmbajtja e tualeteve, është përmendur si një kërkesë që do të ndikonte pozitivisht në përvojën e përgjithshme.
- Bashkëpunimi më i ngushtë me sektorin profesional dhe kompanitë do të ndihmonte në përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës.

Komentet e studentëve tregojnë një përvojë përgjithësisht pozitive dhe një besim të fortë në cilësinë që ofron Universiteti Metropolitan Tirana. Njëkohësisht, ato ofrojnë një orientim të qartë për disa fusha ku është e mundur të punohet më tej për të krijuar kushte më të favorshme studimore dhe për të rritur kënaqësinë e përgjithshme. Përqendrimi në këto pika do të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të institucioni dhe do të forcojë lidhjen me studentët.